



PLANI STRATEGJIK 2015 - 2020



Publikimi u realizua nga **Forumi i Gruas Elbasan**, në kuadër të **Projektit** “Advokim & Lobim nga gra të sukseshme dhe organizatë e fuqishme për çështjet e grave”, me mbështetjen financiare të Qeverisë Suedeze përmes Fondacionit Kvinna till Kvinna (Gruaja tek Gruaja).

Idetë e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimin e Qeverisë Suedeze dhe Fondacionit “Kvinna till Kvinna”.

Përgatiti: Shpresa Banja, Mirela Gjoni, Dhoksi Gjoka, Nertila Toli, Teuta Hoxha, Soela Kurti, Valmira Pajenga, Drilona Llangos.

Kontribuan: Ismete Krasniqi, Zhaneta Qamili, Elisa Gripshi.

Përktheu: Gertjana Hasalla

Falenderojmë për mbështetjen e tyre:

Donatorët, institucionet publike, organizatat partnere, aktivistët e FGE-së dhe gratë/vajzat përfituese të shërbimeve të FGE.

Elbasan, Shtator 2014

Mirënjohje

Mirënjohje për gratë dhe vajzat që prej vitesh na kanë besuar historinë e jetës së tyre dhe me ndihmën e FGE -së janë munduar të ndryshojnë jetën e tyre dhe të fëmijëve të tyre.

Mirënjohje për donatorët tanë që me mbështetjen e tyre bënë të mundur ofrimin e shërbimeve për njerëz në nevojë kryesisht gra dhe vajza me probleme dhune. Një falenderim i veçantë për donatorin strategjik të Forumit të Gruas Elbasan, Qeveria Suedeze e cila përmes Fondacionit Kvinna till Kvinna ka bërë të mundur që shërbimet për gra dhe vajza me probleme dhune të ofrohen që nga viti 2002 e deri më sot.

Mirënjohje për strukturat shtetërore në Qarkun e Elbasanit të cilat në zbatim të detyrimeve ligjore kanë mbështetur gjatë gjithë kohës shërbimet konkrete, fushatat e ndërgjegjësimit, ndërtim kapacitetesh, referim dhe ndërmjetësim të viktimave të dhunës të sugjeruara nga Forumi i Gruas Elbasan. Qarku i Elbasanit është një Qark Unik në të gjithë Shqipërinë për këtë punë të përbashkët që strukturat shtetërore bëjnë me OJF në mbështetje të njerzëve në nevojë.

Nje mirënjohje e veçantë i takon të gjithë stafit të Forumit të Gruas Elbasan, i cili me përkushtimin, profesionalizmin, devotshmëri ia kanë lehtësuar disi jetën grave dhe vajzave të cilat vetëm për shkak të gjinisë kanë bërë një jetë të vështirë .

Forum i Gruas Elbasan ju premtion se të gjithë objektivat e parashikuara në Planin e saj Strategjik do t'i realizojë, pasi FGE si gjithmonë do të ketë edhe mbështetjen tuaj.

Ju faleminderit të gjithëve!

Shpresa Banja
PRESIDENTE

Shkurtime

AMSHC	Agjensia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile
ANTTARK	Qendër Burimore Kombëtare Shqiptare për Asistencë teknike dhe Trajnime.
AWEN	Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri
DAR	Drejtoria Arsimore Rajonale Elbasan
DRSHP	Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik
DRSHKP	Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DPQE	Drejtoria e Policisë së Qarkut Elbasan
DHBGJ	Dhunë me Bazë Gjinore
DHF	Dhunë në Familje
FGE	Forumi i Gruas Elbasan
MPÇSSHB	Ministria e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
MMSR	Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë
MP	Marrëdhënia me Publikun
OJF	Organizatë Jo Fitimprurëse
QKL	Qendra Kombëtare e Liçensimit
QK	Qendra e Këshillimit
QKD	Qendra e Kujdesit Ditor
BE	Bashkimi Evropian
KRAT	Komitetet Rajonale AntiTrafik
KtK	Fondacioni Kvinna till Kvinna
REC	Qendra Rajonale e Mjedisit
SA	Studio Avokatore
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
SIDA	Agjensia e Zhvillimit Ndërkombëtar Suedez
SPZ	Specialist Policie Zone
UM	Urdhër Mbrojtje
UMM	Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtje
USAID	Agjensia e Zhvillimit Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara
DRSHSSHE	Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Elbasan
WAVE	Qendra Europiane për Informim kundër Dhunës

TABELA E PËRMBAJTJES

I.	HYRJE	6
II.	PROFILI I ORGANIZATËS DHE HISTORIA E SAJ	8
III.	PROJEKTET E REALIZUARA NË PERIUDHËN 2008-2014	12
IV.	FILOZOFIA E PLANIT STRATEGJIK 2015 – 2020	15
1.	Vizioni i organizatës	15
2.	Misioni i organizatës.....	15
3.	Vlerat e organizatës.....	15
V.	ANALIZA E MJEDISIT TË BRENDSHËM DHE TË JASHTËM TË ORGANIZATËS..	16
VI.	ÇËSHTJET KRITIKE DHE STRATEGJITË	18
VII.	QELLIMET DHE OBJEKTIVAT	20
A.	PROGRAMI: NDERGJEGJËSIMI	20
B.	PROGRAMI: EDUKIMI	20
C.	PROGRAMI: LOBIMI	20
D.	SHËRBIMI: PSIKO-SOCIAL-LIGJOR PER VIKTIMAT	20
E.	SHËRBIMI: PSIKO-SOCIAL-LIGJOR PËR DHUNUESIT	20
F.	SHËRBIMI: PËR GRATE E MOSHËS SE TRETË	21
	MENAXHIMI: OBJEKTIVAT	22
VIII.	DREJTIMET E PËRGJITHSHME STRATEGJIKE FORUMI I GRUAS ELBASAN 2015 - 2020	24
IX.	MATRICA E PLANIT STRATEGJIK.....	25
X.	PLANI I ZBATIMIT TË AKTIVITETEVE.....	38

I. HYRJE

Plani Strategjik i Forumit të Gruas Elbasan (FGE) për vitet 2015 - 2020, u hartua duke u bazuar në rezultatet dhe përvojat e fituara nga zbatimi i planit të mëparshëm strategjik 2008 - 2013 si dhe në tendencat e reja në fushën e mbrojtjes së të drejtave të grave. Plani Strategjik i mëparshëm shërbeu si një mjet udhëheqës në punën e organizatës, duke i dhënë asaj drejtimet e së nesërme, si dhe mënyrën e realizimit të objektivave të përcaktuara. Duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e këtij instrumenti FGE vendosi të realizojë strategjinë e re për pesë vitet e ardhshme 2015-2020.

FGE do të vazhdojë të kontribuojë në arritjen e barazisë gjinore përmes: programeve të edukimit, ndërgjegjësimit, advokimit; shërbimeve psiko-social-ligjore për dhunën dhe shërbimeve të tjera alternative. Gjatë këtij pesë vjeçari të ardhshëm FGE mendon të zgjerojë aktivitetet e saj duke ofruar shërbime alternative për dhunuesit, burrat e dhunuar dhe gratë e moshës së tretë. Gjithashtu, në këtë plan janë përcaktuar qartë vlerat e organizatës si gurë themeli mbi të cilët ndërtohet dhe zhvillohet gjithçka.

Hartimi i planit strategjik u realizua pas një procesi të gjatë komunikimi dhe bashkëbisedimi me anëtarësinë e organizatës, me bordin dhe ekspertë të saj. Prosesi i hartimit përfshiu vlerësimin & sugjerimet e përfitueseve, organizatave partnere, institucioneve të linjës, si dhe konkretizimin e tyre nga grupi i punës, i përbërë nga 11 persona, 8 anëtarë stafi dhe 3 anëtarë bordi. Gjatë procesit të planifikimit grupi i punës u drejtua nga një konsulent i ANTTARC (Qendra Kombëtare Burimore e Trajnimeve & Asistencës Teknike), ekspert në fushën e planifikimit strategjik.

Procesi i planifikimit dhe përgatitjes së këtij dokumenti kaloi në disa hapa mjaft të rëndësishëm si:

1. Vlerësimi i arritjeve të Planit Strategjik 2008-2013;
2. Workshop i Planifikimit Strategjik dhe hartimi i draftit të parë;
3. Hartimi i draftit të dytë të Planit Strategjik;
4. Paraqitja e draftit të Planit Strategjik bordit të organizatës dhe partnerëve strategjik;
5. Miratimi i Planit Strategjik.

Hapi i parë: Vlerësimi i arritjeve të Planit Strategjik 2008-2013.

Për vlerësimin e arritjeve të planit të mëparshëm grupi i punës organizoi dy takime në të cilat u diskutua mënyra e organizimit të dy fokus grupeve dhe 40 intervistave, si dhe përzgjedhjen e 80 personave të përfshirë në këtë proces.

Në bashkëpunim me konsulentin e ANTTARC, u hartua pyetësori që u përdor për realizimin e intervistave dhe fokus grupeve, si me përfituesit dhe aktorët lokal. Në bazë të këtij instrumenti u realizua analiza SWOT, ku të gjithë përfituesit dhe aktorët lokal ofruan vlerësimet e tyre në lidhje me punën e organizatës, ashtu sikurse ide dhe sugjerime se ku FGE duhet t'i fokusojë programet/shërbimet në 5-vjeçarin e ardhshëm.

Pyetësi përfshinte këto pyetje:

1. Cilat janë pikat e forta dhe të dobëta të organizatës?
2. Çfarë shikoni si mundësi dhe pengesa të organizatës?
3. Cilat janë kriteret që ju përdorni kur gjykoni rreth punës së organizatës?
4. Si kanë qenë rezultatet e organizatës bazuar në kriterin (ose kriteret) që ju keni përdorur për të vlerësuar punën e saj?
5. Çfarë do të dëshironit që organizata të bënte më shumë ose më pak?
6. Në cilat programe dhe/ose shërbime mendoni se duhet të përqëndrohet organizata nëse ka burimet e mjaftueshme në pesë vjeçarin e ardhshëm?

Pas grumbullimit të informacionit nëpërmjet fokus grupeve dhe intervistave u bë përpunimi dhe analizimi paraprak i informacionit nga grupi i punës.

Hapi i dytë: Workshop i Planifikimit Strategjik dhe hartimi i draftit të parë

Drafti i parë i Planit Strategjik u hartua gjatë workshop-it 4 ditor në të cilin u analizua informacioni i gjeneruar paraprakisht rreth pikave të forta e të dobëta të organizatës, rreth nevojave të komunitetit dhe mundësive për të ardhmen.

Gjatë workshop-it grupi i punës punoi mbi:

- Vlerësimin e arritjeve të planit paraardhës dhe përvojave pozitive;
- Rishikimin e misionit dhe vizionit të organizatës;
- Përcaktimin e vlerave të organizatës;
- Analizën e brendshme dhe të jashtme të organizatës;
- Identifikimin e çështjeve kritike dhe strategjive të përgjithshme;
- Përcaktimin e qëllimeve dhe objektivave për programet, shërbimet dhe menaxhimin;
- Përcaktimin e aktiviteteve kryesore;
- Vlerësimin e rreziqeve dhe formulimin e supozimeve.

Në workshop morën pjesë 11 persona, nga të cilët 8 anëtarë stafi dhe 3 anëtarë bordi. Pjesëmarrësit u pajisën me dokumentacionin e nevojshëm, si Plani Strategjik 2008-2013, raporte për realizimin e tij, informacionin e përmbledhur nga fokus grupet dhe intervistat.

Hapi i tretë: Hartimi i draftit të dytë të Planit Strategjik

Grupi i punës, zhvilloi më tej draftin e dytë të planit strategjik duke përcaktuar qartë vizionin, misionin, çështjet kritike, qëllimet, objektivat dhe aktivitetet.

Gjithashtu, u hartua Matrica e Zbatimit Strategjik dhe Plani i Aktiviteteve për periudhën 2015-2020.

Hapi i katërt: Paraqitja/reflektimi i draftit të Planit Startegjik bordit të organizatës dhe partnerëve strategjikë

Drafti i Planit Strategjik u paraqit në mbledhjen e bordit, ku u sugjeruan mendime për përmirësime të mëtejshme. Ky draft u konsultua edhe me partnerët strategjikë të FGE - së. Sugjerimet e bëra nga bordi dhe partnerët strategjikë u reflektuan në Planin Strategjik.

Hapi i pestë: Miratimi i Planit Strategjik

Dokumenti përfundimtar i Planit Strategjik 2015-2020 u prezantua tek bordi dhe presidentja e organizatës, të cilët e miratuan dhe u kaluan për zbatim.

Ky Plan Strategjik synon të zgjerojë dhe të konsolidojë ekspertizën e organizatës në fushën kundër dhunës, trafikut dhe të arritjes së barazisë gjinore, si dhe të fuqizojë kapacitetet menaxhuese, rrjetëzimin dhe vizibilitetin e organizatës.

Gjithashtu, ky Plan Strategjik do t'i shërbejë FGE-së si një udhërrëfyes në gjetjen e zgjidhjeve optimale për përfituesit, forcimin e bashkëpunimit efektiv me institucionet e linjës, si dhe në gjetjen e mënyrave për të arritur qëllimet dhe objektivat e saj në 5-vjeçarin e ardhshëm.

II. PROFILI I ORGANIZATËS DHE HISTORIA E SAJ

Forumi i Gruas Elbasan është një Organizatë Jo Fitimprurëse (OJF), joqeveritare e themeluar në Gusht të vitit 1991, e para shoqatë e këtij lloji e krijuar në rrethin e Elbasanit menjëherë pas ndryshimeve politike që ndodhën në vendin tonë.

Në Janar të vitit 2000, Mbledhja e Përgjithëshme e Anëtarëve vendosi krijimin dhe regjistrimin e Forumit të Gruas Elbasan në Gjykatën e Rrethit Elbasan, si subjekt i pavarur juridik dhe më vonë FGE reregjistrohet në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, me numër vendimi 4030/1 datë 10.07.2003, konform ligjit të Organizatave Jo Fitimprurëse (OJF). FGE është liçensuar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSSH), sot Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë (MMSR) si Organizatë për ofrimin e shërbimeve sociale. Në Qershor 2011 FGE është liçensuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) me numër liçense 3495.

Forumi i Gruas Elbasan në vazhdimësi ka kontribuar për të ndryshuar mentalitete të gabuara në lidhje me gruan, pozicionin e saj në familje dhe në shoqëri, në ndërtimin e kapaciteteve tek gratë me qëllim që të krijojmë shembullin pozitiv të figurës së gruas në shoqëri. Me përkushtim dhe profesionalizëm FGE ka mbrojtur të drejtat e grave duke qenë kryesisht e fokusuar në të drejtën për të qenë e lirë, e pa dhunuar dhe në të drejtën për të qenë e barabartë në jetën publike.

Periudha 2008-2014 mund të konsiderohet periudha e konsolidimit të FGE-së, gjatë së cilës janë përmirësuar dhe zgjeruar shërbimet konkrete; janë intensifikuar fushatat e ndërëgjegjësimi; është zgjeruar ekspertiza dhe janë rritur kapacitetet e stafit; është strukturuar menaxhimi/administrimi i organizatës; janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me të gjithë aktorët publikë në mbështetje të grave me probleme dhune; dhe është rritur numri i donatorëve që kanë mbështetur FGE-në në veprimtarinë e saj. Vlen për tu përmendur, që në vitin 2009 FGE është një nga 8 (tetë) organizatat që themeluan Rrjetin e Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN), një organizatë e cila në këto vite ka rritur vlerat e saj nëpërmjet një

bashkëpunimi frytëdhënës për arritjen e barazisë gjinore në Shqipëri ku padyshim FGE ka dhënë kontributin e saj.

Grupet e mbështetura nga FGE-ja janë veçanërisht gratë dhe vajzat, në Shqipëri dhe më gjerë. Por, në këto vite, FGE gjatë punës për arritjen e barazisë gjinore nuk i ka parë burrat thjesht si “problem”, por si pjesë e zgjidhjes. Në të gjithë takimet sensibilizuese të realizuara burrat/djemtë kanë qenë pjesë aktive e tyre duke dhënë ide të vlefshme që FGE - së i kanë shërbyer në veprimtarinë e saj të përditshme. Kjo ishte një nga arsyet prej së cilës, FGE në projektin e financuar nga BE për vitet 2014-2016, vendosi përfshirjen e një grupi burrash/djemsh si bashkëpunëtorë në fushatat ndërjegjësuere në komunitet kundër Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës në Familje.


Drejtimet kryesore të punës së Forumit të Gruas Elbasan përfshijnë:

- Parandalimin e dhunës me Bazë Gjinore dhe trafikimit të qenieve njerëzore.
- Fuqizimin e grave/vajzave me probleme dhune dhe social-ekonomike.
- Ngritjen e kapaciteteve për përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe joshtetërore në lidhje me çështjet gjinore.
- Lobimim dhe advokaci në mbrojtje të të drejtave të grave/vajzave.

Organizata është e përbërë nga **Asambleja, Bordi Ekzekutiv dhe Presidentja**. Forumi i Gruas Elbasan ka një **staf profesionistësh** të përbërë nga: punonjëse sociale, psikologe, avokate, juriste, financiere, etj. Stafi ka kapacitete trajnuese, menaxhuese e ofruese për shërbime konkrete. Këto kapacitete janë krijuar hap pas hapi, vit pas viti duke marrë në konsideratë faktin se organizata i ka dhënë shumë rëndësi trajnimit dhe kualifikimit të stafit.

E

ORGANIGRAMA FORUMI I GRUAS ELBASAN



gjithë eksperiencia e FGE tregon për një veprimtari të gjërë duke:

- Ofruar shërbime konkrete në favor të grave dhe vajzave;
- Realizuar fushata sensibilizuese;
- Organizuar trajnime dhe ngritje kapacitetesh.

a. Shërbime

Shërbimet konkrete për gra/vajza me probleme dhune realizohen nga:

1. **Qendra e Këshillimit**, ofron shërbime falas në ndihmë të grave/vajzave me probleme dhune dhe social-ekonomike në Qarkun e Elbasanit, por edhe nga Qarqet e tjera të Shqipërisë dhe jashtë saj.

Shërbimet e ofruara nëpërmjet psikologes/punonjësës sociale, janë:

- Mbështetje psikologjike, sociale, individuale dhe në grup;
- Ndërmjetësim me familjarët dhe përfituesit për gjetjen e alternativave drejt zgjidhjes së problemeve;
- Ndërmjetësim në qendrën e Formimit Profesional, në Biznesin Lokal;
- Informim, orientim dhe referim të rasteve për shërbime të tjera alternative të nevojshme të ofruara nga aktorë të tjerë vendor (publikë dhe jopublikë).

Shërbimet e mësipërme ofrohen nëpërmjet:

- **Linjës telefonike**, ku nëpërmjet numrit të telefonit 05425 45-16 përfitueset prezantojnë problemet e tyre duke mbetur anonim.
- **Këshillimit ballë për ballë**, ku vajzat/gratë vijnë direkt në Qendrën e Këshillimit dhe bëjnë prezente problemet dhe shqetësimet e tyre.

2. **Studio Avokatore** është e vetmja në Qarkun e Elbasanit që ofron shërbim ligjor falas. Shërbimet janë:

- **Konsulencë juridike**, e cila jepet në rastet kur përfituesja kërkon të sqarojë një problem ligjor.
- **Hartimi i akteve juridike**, drejtuar gjykatës për fillimin e çështjeve gjyqësore (kërkesë padi, kërkesa ankimore, etj.) apo drejtuar institucioneve të publike për sigurimin e informacionit të nevojshëm për proces gjyqësor (prova shkresore).
- **Mbrojtje ligjore me avokat** për të gjitha përfitueset, që janë viktimat të dhunës në familje.

3. **Qendra e Kujdesit Ditor (shelter emergjence)** është e vetmja në gjithë Shqipërinë. Kjo qendër lindi si nevojë e asistimit dhe mbështetjes së grave të dhunuara, të cilat denoncojnë dhunuesit e tyre, janë në rrezik e kërkojnë të pajisjen me Urdhrin e Menjëhershëm të Mbrojtjes.

Shërbimet e ofruara nëpërmjet punonjësës sociale janë:

1. Strehim nga disa orë deri në 5 ditë, në pritje të marrjes së Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes, për vajza/gra dhe fëmijët e tyre nën 18 vjeç.
2. Vazhdim i këshillimit psiko-social-ligjor e mjekësor nga QK dhe SA-ja gjatë ditëve të akomodimit.

Gjatë qëndrimit në QKD, gruas bashkë me fëmijët u ofrohen kushte normale akomodimi, jetese, ushqimi, veshmbathje në varësi të nevojave. Ruhet fshehtësia, sekretet dhe anonimiteti i

çdo përfitueseje si dhe i QKD. Me pajisjen e gruas me UMM bëhet kalimi në një strehëz tjetër me afat më të gjatë, ose rikthimi në banesë, në varësi të rrishtit që paraqet rasti dhe dëshirës së përfitueses.

b. Fushata sensibilizuese

FGE është një ndër organizatat më aktive në organizimin e fushatave të ndërgjegjësimit për çështjet gjinore. Konkretisht:

- ✚ Organizon forume në komunitet me gra/vajza, burra/djem, përfaqësues të pushtetit vendor në lidhje me: DHF, DHBGJ, Trafikimin, Barazinë Gjinore në Politikë dhe Vendimmarrje.
- ✚ Realizon materiale ndërgjegjësuese: spote, cikël emisionesh në TV dhe radio, publikime, fletë-palosje, postera, shkrime të ndryshme në mediane dhe shkruar dhe sociale.
- ✚ Organizon sesione fuqizimi në qendër me gra/vajza përfituese të shërbimeve, të cilat shkëmbejnë eksperiencë, marrin informacion mbi të drejtat e tyre dhe shërbime nga të cilat mund të përfitojnë.

c. Trajnime

Organizata ka realizuar trajnime për aktorë të ndryshëm lokal për tema të cilat kanë patur në qendër çështjet gjinore. Disa prej të cilave janë:

- Trajnim me këshilltarët lokal mbi ligjin “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” dhe Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje.
- Trajnimi i Specialistëve të Policisë së Zonës (SPZ) për nocionet e barazisë gjinore, mënyrën e trajtimit të rasteve të grave të dhunuara, përgatitja e UMM/UM për gratë dhe fëmijët e dhunuar.
- Trajnimi i administratorëve të njësive administrative për përfitimin e ndihmës ekonomike nga viktimat e dhunës në familje të pajisur me UMM/UM.
- Trajnimi i djemve/burrave mbi konceptet e barazisë gjinore, DHF dhe DHBGJ.
- Trajnim lidhës për gratë anëtare/aktiviste të forcave politike dhe shoqërisë civile.
- Trajnimi i drejtuesve të forcave politike për barazinë gjinore, rolin dhe të drejtat e grave në politikë dhe vendimmarrje.

FGE për realizimin e objektivave të saj bashkëpunon dhe kooperator me institucione shtetërore në nivel qendror/lokal si dhe me shumë organizata partnere, ku mund të përmendim: Tjetër Vizion, Në Dobi të Gruas Shqiptare dega Elbasan, World Vizion, etj.

Disa nga institucionet shtetërore me të cilat FGE ka marrëveshje bashkëpunimi janë:

- Këshilli i Qarkut Elbasan;
- Bashkia Elbasan;
- Drejtoria e Policisë së Qarkut Elbasan (DPQE);
- Ministria e Punës Çështjeve Sociale dhe e Shanseve të Barabarta (MPCSSH) sot Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR);
- Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror (DRShSSh), Elbasan;
- Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë (DRSH), Elbasan;
- Drejtoria Rajonale Arsimore (DAR), Elbasan;
- Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Punësimit (DRSHKP), Elbasan;
- Universiteti “Aleksander Xhuvani”.

Gjithashtu, FGE ka një partneritet të zgjeruar me organizata e rrjete kombëtare e ndërkombëtare si më poshtë:

- Komiteti Rajonal Antitrafik (KRA);
- Komiteti Drejtues dhe Ekipi Teknik për “Mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e proçedimit të tij”;
- Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN);
- Qendra Evropiane e Informimit Kundër Dhunës (WAVE) - Pikë fokale për Shqipërinë.

III. PROJEKTET E REALIZUARA NË PERIUDHËN 2008-2014

Forumi i Gruas Elbasan gjatë 6 viteve të fundit të veprimtarisë së saj është mbështetur nga 14 donatorë të ndryshëm. Falë mbështetjes së tyre organizata ka arritur të realizojë objektivat e synuara në mbrojtje të të drejtave të grave/vajzave. Projektet kryesore të realizuara dhe donatorët mbështetës, janë si më poshtë:

Qeveria Suedeze përmes Fondacionit Kvinna till Kvinna ka vazhduar mbështetjen financiare për FGE në mënyrë të pandërprerë për projektin “Fuqizim i grave viktime të dhunës në familje në Qarkun e Elbasanit”. Përqindjet e financimit kanë qenë si më poshtë:

Vitet 2008, 2009, 2010 - 100% të mbështetura nga Qeveria Suedeze përmes Fondacionit Kvinna till Kvinna.

Viti 2011 – 80 % të mbështetur nga Qeveria Suedeze përmes Fondacionit Kvinna till Kvinnadhe 20% AMSHC (Agjensia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile) një strukturë e Qeverisë Shqiptare për të mbështetur OJF-të.

Vitet 2012-2014 – 15 % të mbështetur nga Qeveria Suedeze përmes Fondacionit Kvinna till Kvinnadhe 85 % BE, për herë të parë FGE merr fonde nga Bashkimi Evropian.

Ky ka qenë dhe projekti kryesor që FGE ka realizuar në periudhën 2008-2014. Qëllimi kryesor i këtij projekti ishte vazhdimi i shërbimeve falas për gratë dhe vajzat viktime të dhunës në familje. Ka funksionuar kryesisht në dhënien e shërbimeve konkrete për gratë/vajzat në nevojë por dhe më një fushatë të fuqishme në komunitet për të ndryshuar qëndrimin e shoqërisë ndaj problemeve të dhunës në përgjithësi dhe të dhunës në familje në veçanti.

Disa nga treguesit e arritur në këtë periudhë janë si më poshtë:

Këshillime nëpërmjet telefonit **723**, këshillime ballë për ballë **2478** këshillime juridikë **1080**, janë përfaqësuar **463** raste në Gjykatë, janë hartuar **471** akte ligjore.

Për herë të parë në këtë periudhë me mbështetjen e BE, FGE hap QKD unike në gjithë Shqipërinë. Janë asistuar/akomoduar gjithsej në këtë qendër për këtë periudhë **32** gra, të shoqëruara nga **40** fëmijët e tyre. Kemi patur raste kur janë strehuar edhe vajza, gjithsej **7**.

Ndërgjegjësimi i komunitetit një komponent shumë i rëndësishëm i punës së FGE është realizuar:

1. përmes takimeve në shkolla, komunitet ku kanë marrë pjesë:

Në shkolla janë realizuar **295** takime, kanë marrë 4931 të rinjë, **1915** djem dhe **3016** vajza.

Në komunitet janë organizuar **558** takime, kanë marrë pjesë 11784 persona, **4649** burra/djem dhe **7135** vajza/gra.

2. Pregatitjes dhe shpërndarjes së materialeve ndërgjegjësuere:

Janë prodhuar dhe shpërndarë **5950** fletëpalosje, **500** postera, **5** banera.

3. Përmes emisioneve në TV lokale, radiot lokale si dhe me shkrime të ndryshme në gazetatat lokale

Janë realizuar **7** emisione për ti thënë stop dhunës në familje/shoqëri, janë dhënë me dhjetra intervista në TV lokale dhe kombëtare.

Janë realizuar **5** emisione në radion KLEA, ne Radio Tirana, etj.

Në funksion të projektit kryesor FGE realizoi projektin dyvjeçar "Forcimi i Sistemit të Transparencës, Efikasitetit dhe Paanshmërisë në Gjykatat Shqiptare, përmes përmirësimit të Cilësisë së Përfaqësimit në Gjykim dhe Rritja e Kapacitetit të Shoqërisë Civile në Monitorimin dhe Adresimin e këtyre çështjeve" mbështetur nga JuST një eksperiencë e re dhe shumë frytdhënëse për target grupin kryesor.

Një drejtim tjetër shumë i rëndësishëm i FGE në këtë periudhë ka qenë puna për të rritur rolin e grave në një proces vendimmarrje. Donatrët kryesor që na kane mbështetur për të realizuar këtë objektiv kanë qenë: UNWOMEN (UNIFEM), Ambasada Amerikane, Qeveria Suedeze përmes Fondacionit "Kvinna till Kvinna". Ne procesin e buxhetimit me pjesëmarrje, proces pothuaj unik ky në të gjithë Shqipërinë që prej vitesh realizohet në Bashkinë e Elbasanit, FGE arriti të ketë mbi 50% të pjesëmarrësve në takim të jenë gra, rreth 50% e komisionerëve të zgjedhur të jenë gra, shumica e prioriteteve të miratuara ishin propozuar nga grate.

Bashkia Vjenë, Austri përmes Horizont 3000 dhe Welthaus kanë mbështetur FGE për katër vite rradhazi për parandalimin e trafikimit në grupmoshën 15-20 vjeç, në zhvillimin e kurseve

profesionale të kësaj grupmoshe me qëllim punësimin e tyre dhe reduktimin e mundësisë për tu trafikuar, informimin në lidhje me aksesin që gratë/vajzat kanë në sistemin e arsimit dhe të shëndetësisë. Në kuadër të këtij projekti kanë ndjekur kursin profesional **140** vajza, kanë marrë informacion për edukimin dhe shëndetësinë **2000** vajza/gra të reja. Është përgatitur **50** postera, **450** fletëpalosje dhe një botim me titull “Parandalo trafikimin dhe shpëto një jetë vajze”.

Por, FGE ka qënë e suksesshme në këtë periudhë edhe në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Me mbështetjen e REC, FGE i ka dhuruar qytetit të Elbasanit dy zona të gjelbërta njëra tek Rajoni Nr. 4 dhe tjetra tek Rajoni Nr. 1. Me mbështetjen e Bankës Botërore u organizuan takime informuese për publikun në qytetin e Prrenjësit për Konventën e Aarhusit dhe të drejtat që kanë qytetarët në lidhje me këtë Konventë si e drejta për tu informuar, e drejta për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe e drejta për t’ju drejtuar gjykatës.

IV. FILOZOFIA E PLANIT STRATEGJIK 2015 – 2020

1. *Vizioni i organizatës*

Grua e fuqizuar, familje dhe shoqëri e emancipuar.

2. *Misioni i organizatës*

FGE kontribuon në arritjen e barazisë gjinore përmes: programeve të edukimit, ndërgjegjësimit, advokimit; shërbimeve psiko-social-ligjore për dhunën dhe shërbimeve të tjera alternative.

3. *Vlerat e organizatës*

- **Humanizmi:** Ne drejtohem nga interesat, vlerat dhe dinjteti ndaj njerëzve.
- **Toleranca:** Ne dëgjojmë dhe pranojmë pa diskriminuar.
- **Ndjeshmëria:** Ne trajtojmë çdo person me respekt dhe dinjtet.
- **Përgjegjshmëria:** Ne përdorim në mënyrë efektive burimet njerëzore dhe financiare.
- **Mikpritja:** Ne karakterizohemi nga ndjenja e mikpritjes.
- **Gadishmëria:** Ne jemi të gatshëm në çdo kohë që na kërkohet ndihmë.
- **Këmbëngulja:** Ne jemi insistues dhe këmbëngulës në arritjen e qëllimeve dhe misionit tonë.
- **Përkushtimi:** Të dedikuar për misionin tonë.
- **Bashkëpunimi:** Ne punojmë në partneritet në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.
- **Vullnetarizmi:** Ne ofrojmë ekspertizën tonë.
- **Efektiviteti:** Ne ofrojmë shërbime cilësore në përputhje me nevojat e përfituesve.

V. ANALIZA E MJEDISIT TË BRENDSHËM DHE TË JASHTËM TË ORGANIZATËS

	Pikat e forta	Pikat e dobëta
Mjedisi i brendshëm	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Shërbime cilësore, unike dhe të liçensuara në Qarkun e Elbasanit; ▪ Organizatë me eksperiencë 23 vjeçare; ▪ Staf teknik kompetent dhe profesional; ▪ Aftësi të mira komunikimi, ngrohtësia, disponibiliteti, përkushtimi dhe fleksibiliteti i stafit; ▪ Struktura organizative efektive; ▪ Organizatë serioze dhe me reputacion pozitiv; ▪ Të qëndruarit brenda misionit; ▪ Vizibiliteti në media; ▪ Organizatë me një mendësi të hapur, mikpritës, mosdiskriminues; ▪ Mjedise dhe pajisje zyre të mjaftueshme për një aktivitet normal; ▪ Lidërsip efektiv; ▪ Fonde të sigurta edhe për 2 vjet të tjera; ▪ Aktivë në programe Advokacie & Lobimi për të drejtat e grave; ▪ Marrëveshje efektive bashkëpunimi me institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore; ▪ FGE është partnere, anëtare e rrjeteve kombëtare dhe ndërkombëtare të grave për dhunën ndaj grave dhe problemeve gjinore; ▪ FGE është anëtare e strukturave shtetërore për dhunën dhe antitrafikun; ▪ Sistem i informatizuar, efektiv & eficient financiar "Alpha Business", 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Shërbime dhe programe të pamjaftueshme për gratë dhe dhunuesit; ▪ Mjedise me qera dhe mungesa e një mjete transporti; ▪ Aftësi të pamjaftueshme për ngritjen e fondeve; ▪ Staf dhe bord vetëm me gra; ▪ Statusi i organizatës i papërditësuar; ▪ Mungesa e aftësive të IT-së dhe anglishtes profesionale; ▪ Shtrirja gjeografike e pjesshme e shërbimeve në Qark; ▪ Institucionalizimi jo i mjaftueshëm i marrëdhënieve me median; ▪ Mungesa e një arkive dixhitale, software për mbajtjen e të dhënave për përfituesit dhe vullnetaret.
	Mundësitë	Pengesat

- | | |
|--|--|
| <ul style="list-style-type: none"> ▪ Njohja e nevojave prioritare të komunitetit lidhur me misionin tonë; ▪ Nevoja për shërbimet e shoqatës jo vetëm për Qarkun e Elbasanit (Shqipëri dhe në vendet me emigrantë shqiptar); ▪ Prirje në rritje e individëve që kontribuojnë vullnetarisht në organizatë; ▪ Bashkëpunim me institucionet qëndrore, lokale, OJF, median; ▪ Funksionimi normal i rrjetit rajonal për dhunën; ▪ Ekzistenca e disa mekanizmave shtetërorë për dhunën dhe trafikimin; ▪ Ka organizata lokale dhe kombëtare që advokojnë për të drejtat e grave; ▪ Ka ekspertë të jashtëm/organizata për shkrimin e projekt-propozimeve dhe rritjen e kapaciteteve të stafit; ▪ Sistemi i referimit dhe orientimit për shërbimet e nevojshme ndaj përfituesve; ▪ Fonde nga qeveria përmes AMSHC; ▪ Ka donator që financojnë programe për gratë/vajzat (BE, Qeveria Suedeze, etj...). | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Mungesa e lehtësirave fiskale ndaj bizneseve për të kontribuar në programe/shërbime sociale; ▪ Mbështetje e kufizuar për shërbimet nga donatorët; ▪ Media jo profesionale në trajtimin e çështjeve gjinore; ▪ Bazë ligjore e paspecifikuar për tenderimin e shërbimeve të ofruara nga OJF-të; ▪ Konkurrencë informale dhe e pandershme (korrupsioni, rryshfeti, njohja, etj.); ▪ Hendeku midis zbatimit të ligjeve dhe dokumentacioneve strategjike, kapaciteteve të stafit dhe alokimit të fondeve të nevojshme; ▪ Vartësia nga fondet e donatorëve të huaj; ▪ Mentaliteti maskilist; ▪ Donatorë në ikje; ▪ Pritshmëri jo realiste dhe rezistencë ndaj shërbimeve nga ana e përfituesve. |
|--|--|

VI. ÇËSHTJET KRITIKE DHE STRATEGJITË

1. Forumi i Gruas Elbasan është një **organizatë me eksperiencë disa vjeçare** që operon në Qarkun e Elbasanit për arritjen dhe gëzimin e të drejtave nga gratë. Një nga prioritetet e punës së stafit do të jetë **njohja e vazhdueshme e nevojave të komunitetit lidhur me misionin tonë**. Pikat ku do të bazohet strategjia për të arritur këtë çështje kritike janë:

- Vazhdimësi në vlerësimin e nevojave specifike të komunitetit në përputhje me misionin e organizatës.
- Përdorimi i metodave të ndryshme për sigurimin e një informacioni relevant lidhur me nevojat (intervistat individuale dhe në grup, fokus grupet, vëzhgimet, etj.).
- Përfshirja e përfituesve dhe anëtarëve të komunitetit në studimin e nevojave të grupeve të synuara.

2. Forumi i Gruas Elbasan ofron prej vitesh **shërbime konkrete për gratë me probleme dhune**. Qendra e Këshillimit, Studio Avokatore dhe Qendra e Kujdesit Ditor (strehëza e emergjencës) janë të vetmet në Qarkun e Elbasanit, ndërsa shërbimi i fundit është i vetmi në gjithë Shqipërinë. Shërbimet janë të licensuara dhe në përputhje të plotë me standartet kombëtare. *Për ofrimin e këtyre shërbimeve punon një ekip multidisiplinar me eksperiencë dhe ekspertizë në fushë. Strategjitë e përgjithshme të FGE-së për ofrimin e shërbimeve cilësore në periudhën 2015 - 2020 do të përfshijnë:*

- Vazhdimësi në ofrimin e programeve dhe shërbimeve cilësore.
- Shtrirja e shërbimeve brenda dhe jashtë vendit.
- Shtimi i shërbimeve dhe i target grupeve (përfshirja e burrave të dhunuar).
- Ofrimi i shërbimeve/programeve alternative për burrat dhunues.
- Hartimi i nje strategjie të organizatës për marrëdhëniet me publikun.
- Gjetja e alternativave/praktikave të mira/inovative për ngritjen e kapaciteteve të vazhdueshme të stafit dhe të vullnetarëve.
- Ofrimi i eksperiencës së FGE-së për ngritjen dhe zhvillimin e organizatave të tjera të ngjashme.

3. FGE është **aktive në programe Advokacie & Lobimi për të drejtat e grave** si në nivel vendor dhe qendror. Arritja e barazisë gjinore është në themel të punës së FGE. Strategjitë për të arritur këtë çështje janë:

- Kontakte me aktorët lokal&qendror për identifikimin e çështjeve advokuese.
- Vigjilenca periodike ndaj thirrjeve/propozimeve, programeve advokuese.
- Përfshirja e medias në proceset advokuese.
- Advokim në pushtetin qendror në bashkëpunim me organizatat partnere për zbatimin korrekt të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore e Dhunës në Familje.
- Forcimi i bashkëpunimit me partnerët kombëtar e ndërkombëtar.

4. FGE është një organizatë e qëndrueshme financiarisht, por që varet nga fondet e donatorëve. Donatorët kryesorë gjatë periudhës së kaluar përfshijnë Bashkimin Evropian, Qeverinë Suedeze përmes “Fundacionit Kvinna till Kvinna” , Ambasadën Amerikane, Agjensinë e Zhvillimit Austriak, UN Women, AMSHC, REC, etj. Aktualisht, FGE është duke u financuar nga Bashkimi Evropian, Qeveria Suedeze përmes “Fundacionit Kvinna till Kvinna”. Kryesisht financimi nga ana e donatorëve është bërë për një periudhë deri në 2 vjeçare. *Varësia nga donatorë afatgjatë është një çështje kritike e cila duhet adresuar në vitet e ardhshme me strategjitë e mëposhtme:*

- Identifikimi dhe ndërtimi i një banke të dhënash me donatorë potencialë.
- Diversifikimi i burimeve financiare.
- Rritja e aftësive të stafit për ngritjen e fondeve .
- Gjetja e mënyrave inovative për të tërhequr fonde nga biznesi, individit dhe institucione fetare.
- Pjesëmarrje në advokimin për një bazë ligjore të përshtatshme lidhur me përfshirjen e OJF-ve në tenderimin e shërbimeve.
- Gjenerimi i të ardhurave nëpërmjet ofrimit të trajnimeve, konsulencës me pagesë nga stafi i shoqatës.
- Rritja e të ardhurave nga anëtarësimi në shoqatë.

5. FGE ka një arkiv shumë vjeçar të punës së saj, por ka një **mungesë të një arkive dixhitale**, software për mbajtjen dhe analizimin e të dhënave nga përfituesit dhe vullnetaret. Për arritjen e realizimit të një arkive dixhitale mendojmë të përdorim këto strategji:

- Dizajnimi i programit/software.
- Trajnimi i stafit
- Mirëmbajtja e vazhdueshme e programit/software

VII. QELLIMET DHE OBJEKTIVAT

A. PROGRAMI: NDERGJEGJËSIMI

Qëllimi: **Promovimi i barazisë gjinore në jetën familjare dhe shoqërore**

- | | |
|-----|--|
| A1. | Objektivi: Rritja e vetëdijes së aktorëve lokal për problemet e dhunës dhe trafikimit |
| A2. | Objektivi: Rritja e vetëdijes së aktorëve lokale mbi rëndësinë e një përfaqësimi /pjesëmarrje të barabartë gjinore. |

B. PROGRAMI: EDUKIMI

Qëllimi strategjik: **Aftësimi i fëmijëve dhe të rinjve mbi konceptet e çështjeve gjinore.**

- | | |
|-----|--|
| B1. | Objektivi: Njohja me konceptet bazë të barazisë gjinore |
| B2. | Objektivi: Rritja e kapaciteteve të edukatorëve/mësuesve mbi konceptin gjinor për përcjelljen e tyre tek brezat e rinj. |

C. PROGRAMI: LOBIMI

Qëllimi: **Mbrojtja e të drejtave të grave/vajzave**

- | | |
|-----|---|
| C1. | Objektivi: Përmirësimi i mekanizmave ligjorë kundër dhunës dhe pabarazisë nëpërmjet përfshirjes në iniciativa kombëtare e ndërkombëtare advokuese |
| C2. | Objektivi: Rritja e kapaciteteve të institucioneve shtetërore dhe joshtetërore për zbatimin efektiv të politikave ekzistuese kombëtare për barazinë gjinore dhe dhunën |
| C3. | Objektivi: Forcimi i bashkëpunimit me rrjetet ku FGE bën pjesë dhe përfshirja në rrjete të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare |

D. SHËRBIMI: PSIKO-SOCIAL-LIGJOR PER VIKTIMAT

Qëllimi strategjik: **Fuqizimi i grave/vajzave dhe individëve viktimë të dhunës në familje për tu përballur me sfidat e jetës**

- | | |
|-----|---|
| D1. | Objektivi: Çlirimi emocional i grave/vajzave, individëve viktimë të dhunës në familje |
